R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8952, DATË 10.10.2002, "PËR LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK TË SHTETASVE SHQIPTARË", TË NDRYSHUAR"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj synon krijimin e mundësisë për pajisjen me letërnjoftim digjital (*e-letërnjoftim*) për të gjithë shtetasit e pajisur me letërnjoftim elektronik, në zbatim të ligjit nr.8952, datë 10.10.2002, "Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë", të ndryshuar, me qëllim përmbushjen e agjendës politike të qeverisë shqiptare, në kuadër të digjitalizimit, modernizimit të sistemeve elektronike, si dhe zbatimin e skemave të sigurta të shërbimeve *e-ID*. Pajisja me letërnjoftim digjital (*e-letërnjoftim*) ka për qëllim përmirësimin dhe standardizimin e mënyrave të identifikimit të qytetarëve në ambientin digjital.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, që paraqiten për miratim në Këshillin e Ministrave, për Ministrinë e Brendshme.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Më 11 prill 2024, Bashkimi Evropian miratoi rregulloren 2024/1183, që ndryshon rregulloren e Bashkimit Evropian 910/2014 në lidhje me krimin e kuadrit për identitetin digjital evropian. Ky projektakt ka synuar të përmirësojë dhe të standardizojë mënyrat e identifikimit të qytetarëve në ambientin digjital. Identiteti digjital, si një mjet që mundëson njohjen e një personi në ambientin digjital, përfshin informacione personale, si: emrin, datën e lindjes, adresën dhe të tjera të dhëna të rëndësishme, duke krijuar mundësinë e sigurimit të një përputhjeje të lartë të standardeve dhe sigurisë në të gjitha vendet anëtare, për të lehtësuar lëvizjen e komunikimin nëpërmjet platformave digjitale brenda Bashkimit Evropian dhe për të forcuar sigurinë e mbrojtjen e të dhënave personale.

Ky projektligj nuk synon përafrimin e kësaj rregulloreje. Sidoqoftë, hartimi i këtij ligji ka mbajtur në konsideratë parimet e kësaj rregulloreje, si dhe nevojën që, me përafrimin e kësaj rregulloreje në legjislacionin shqiptar, letërnjoftimi digjital, si instrumenti, nëpërmjet të cilit mund të provohet identiteti digjital, të kishte bazën e duhur ligjore për t'u krijuar. Në këtë drejtim, ndryshimet e propozuara nëpërmjet këtij projektligji për krijimin e letërnjoftimit digjital janë në përputhje me parashikimet e ligjit nr.107/2015, "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", që ka përafruar pjesërisht rregulloren 910/2014.

Për këtë arsye, miratimi i këtij projektligji do të përmbushë objektivat e qeverisë në drejtim të identitetit digjital, duke standardizuar identifikimin e qytetarëve në nivel evropian dhe duke implementuar një identitet digjital të përbashkët, i cili mund të lehtësojë komunikimin e bashkëpunimin me institucionet dhe bizneset evropiane. Gjithashtu, një identitet digjital i përbashkët mund të ndihmojë në luftën kundër krimit të organizuar dhe mashtrimeve në internet, duke rritur sigurinë e besueshmërinë e transaksioneve *on-line*. Ministria e Brendshme e, në veçanti, shoqëria aksionare IdentiTek, si shoqëria që prodhon e shpërndan dokumente biometrike për shtetasit shqiptarë dhe/ose shtetasit e huaj me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, sjellin këtë propozim, në përputhje me kuadrin rregullator në Republikën e Shqipërisë, në tërësi, si dhe në përmbushje të kompetencave, sipas vendimit nr.80, datë 14.2.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e shoqërisë aksionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike".

Ndryshimi i ligjit do të krijojë një bazë të ligjshme për pajisjen e shtetasve shqiptarë me letërnjoftim digjital, duke e lejuar këtë proces, në përputhje me standardet e kërkuara nga Bashkimi Evropian, që siguron një bazë të fortë ligjore për pajisjen me letërnjoftim digjital, duke ulur kostot, duke përshpejtuar zbatimin e duke garantuar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare. Kjo do të kontribuojë në modernizimin e administratës publike dhe do të lehtësojë aksesin e qytetarëve në shërbime digjitale. Kjo ndërhyrje do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe institucional të vendit, duke përmirësuar cilësinë e jetës për qytetarët e duke rritur konkurrueshmërinë e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Kjo nismë do të kontribuojë në arritjen e qëllimeve strategjike të qeverisë së Shqipërisë, duke përfshirë strategjinë ndërsektoriale "Agjenda digjitale e Shqipërisë" dhe të planit të veprimit 2022-2026, miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.370, datë 1.6.2022. Strategjia ndërsektoriale synon të përcaktojë objektivat për vitet e ardhshme, duke ndjekur platformat moderne të të dhënave dhe teknologjitë digjitale sipas nevojave të qytetarëve, duke kapërcyer mungesën e burimeve, duke avancuar më tej me digjitalizimin e shërbimeve qeveritare.

Ndryshimi i ligjit ekzistues do të mundësojë një kalim më të shpejtë dhe më efikas në sistemin e identifikimit digjital, pa pasur nevojë për një proces të gjatë legjislativ. Gjithashtu, ndryshimet e propozuara në ligjin aktual nuk do të ndikojnë në tërësinë e tij. Kjo nënkupton se strukturat dhe proceset ekzistuese do të mbeten të stabilizuara, duke minimizuar ndërlikimet ligjore dhe administrative që mund të lindin nga një ligj tërësisht i ri, si dhe paraqitet si një opsion më ekonomik krahasuar me hartimin e një ligji të ri, duke reduktuar kostot administrative dhe procedurat e nevojshme për një ndryshim të tillë.

Aktualisht, nuk ekziston asnjë parashikim ligjor që lejon ose rregullon përdorimin e letërnjoftimeve digjitale. Në mungesë të një kuadri ligjor, identifikimi digjital nuk mund të përdoret si mjet i njohur zyrtarisht për transaksione administrative, publike ose private. Projekti do të ketë ndikime pozitive sociale, ekonomike dhe në mjedis, kundrejt disavantazheve për implementimin e tij, si zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme, e cila do të kërkojë financime të konsiderueshme.

Propozimi për ndryshimin e këtij projektligji me risinë e letërnjoftimit digjital vjen në një linjë me Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, ku projekti “Identiteti digjital për shtetasit shqiptarë” është pjesë e listës, shtuar me vendimin nr.533, datë 12.8.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për një ndryshim në vendimin nr.161, datë 20.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2025–2027””.

Ky projekt, nga pikëpamja strategjike, është i rëndësishëm për vendin dhe ndërlidhjen e tij me rajonin e më gjerë (është pjesë e agjendës së lidhjes së vendit dhe rajonit).

Projekti do të realizohet në tri faza: Projektimi dhe ndërtimi i infrastrukturës (1 vit); zbatimi i projektit pilot (1 vit); implementimi i gjerë i identitetit digjital në të gjithë popullatën e Republikës së Shqipërisë (1 vit); mirëmbajtja (në vazhdim).

Kostoja totale e projektit është 5 012 645 600 ALL. Të dhënat financiare nga formularët përkatës, sipas vendimit nr.887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, të plotësuar për projektin që u përfshi në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, paraqiten, si më poshtë vijon:

- Gjatë vitit të parë parashikohet ndërtimi i infrastrukturës së teknologjisë digjitale për projektin;
- Gjatë vitit të dytë parashikohen kostot operacionale, duke u bazuar në një

numër aplikueshmërie prej 360 000 të shtetasve shqiptarë;
- Gjatë vitit të tretë parashikohen kostot operacionale, duke u shtrirë në një numër aplikueshmërie prej 3 600 000 të shtetasve shqiptarë;
- Gjatë vitit të katërt parashikohen kostot operacionale, duke u bazuar në numrin e mësipërm të aplikueshmërisë, si dhe kosto të tjera mirëmbajtjeje.

Projekti do të gjenerojë përfitime direkte dhe indirekte, reduktim të kostos dhe përmirësim të sigurisë e të privatësisë, ka impakt social, duke rritur punësimin, redukton kohën fizike të proceseve, si dhe ndikon pozitivisht në mjedis.

Krijimi i kësaj platforme teknologjike të specializuar do të bazohet te rregulloret e Bashkimit Evropian mbi identitetin digjital, duke mundësuar shërbimet, si më poshtë vijon:

1. Lëshimi i kredencialeve digjitale për entet publike në fushat, si p.sh.: edukim, shëndetësi, postë, transport;
2. Lëshimi i kredencialeve digjitale për entet private në fushat, si p.sh.: sistem bankar, noteri, telekomunikacion, hoteleri;
3. Shërbimet e verifikimit të identitetit dhe të atributeve për entet publike dhe private etj.

Projekti "Identiteti digjital për shtetasit shqiptarë" është një hap drejt modernizimit, integrimit në Bashkimin Evropian dhe përmirësimit të shërbimeve publike. Ky hap do të lehtësojë në mënyrë graduale proceset ekonomike si brenda vendit, por edhe në ato ndërkufitare, duke dhënë impakt pozitiv si për qytetarët, ashtu dhe për ekonominë e vendit.

Indikator performance do të jetë përqindja e qytetarëve të pajisur me letërnjoftim digjital, ku, brenda vitit të tretë të zbatimit të projektligjit, synohet që 50% e qytetarëve duhet të jenë pajisur me letërnjoftim digjital. Fluksi/numri i pajisjes së shtetasve me letërnjoftimin digjital do të varet ndjeshëm nga aktet nënligjore, që do të pasojnë miratimin e ligjit. Megjithatë, gjatë hartimit të studimit të fizibilitetit u morën në konsideratë vlerësime të INSTAT-it, që lidhen me përdorshmërinë e teknologjisë së informacionit, që mund të jetë një nga indikatorët për të kuptuar më qartë shtetasit, që do të kenë më shumë akses në letërnjoftimin digjital. Sipas INSTAT-it, shpërndarja e përdorimit të TIK-ut sipas grup-moshës për vitin 2023 paraqitet, si më poshtë vijon:

Grup-mosha	Përdoruesit TIK			
	2023			
	Gjatë 3 muajve të fundit	Midis 3 muajve dhe një viti më parë	Më shumë se 1 vit më parë	Asnjëherë nuk e kam përdorur
16-24	99.1	0.8	-	0.2
25-34	97.9	0.4	0.4	1.3
35-44	91.7	2.3	0.6	5.4
45-54	80.9	3.5	3.4	12.1
55-64	69.8	4.0	4.9	21.4
65-74	52.7	4.4	10.5	32.3
Gjithsej	**83.1**	**2.5**	**3.0**	**11.4**

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, si dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projektligj nuk synon përafrim me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përbëhet nga 10 nene, si më poshtë vijon:

Në nenin 1 të projektligjit parashikohet shtimi i fjalëve "... dhe digjital ..." në titullin e ligjit në fuqi.

Në nenin 2 të projektligjit parashikohet shtimi i fjalëve "... elektronik ose digjital ..." në nenin 1 të ligjit në fuqi.

Në nenin 3 të projektligjit parashikohet shtimi i mundësisë për pajisjen me letërnjoftim digjital, si një nga dy format e letërnjoftimit. Gjithashtu, parashikohet se në pikën 4, të nenit 2, pas fjalës "... letërnjoftim ..." shtohet fjala "... elektronik ..." për të qartësuar ndarjen ndërmjet dy llojeve të letërnjoftimit dhe mënyrës së pajisjes me secilën nga dy format, ku është reflektuar ndryshimi

i pikës 5, në të cilën parashikohet se rregullat dhe procedurat për paraqitjen e kërkesës për pajisjen me letërnjoftimin elektronik dhe digjital, pajisja, si dhe dokumentet e nevojshme që shoqërojnë kërkesën përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.

Në nenin 4 të projektligjit parashikohet të hiqet fjala "... elektronik ...", në nenin 5, të ligjit në fuqi.

Në nenin 5 të projektligjit parashikohen rastet e pajisjes me letërnjoftim të ri, në nenin 5, të ligjit në fuqi.

Në nenin 6 të projektligjit parashikohet ndryshimi i shkronjës "b", të nenit 5/1 të ligjit, në përputhje dhe me ndryshimin e propozuar për nenin 5 të ligjit.

Në nenin 7 të projektligjit përcaktohet përkufizimi i letërnjoftimit digjital, si dhe elementet, që përfshihen në të. Gjithashtu, parashikohet se të dhënat e tjera teknike, që përfshihen në letërnjoftimin digjital, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 8 të projektligjit parashikohet shtimi i nenit 6/1, i cili përcakton që shoqëria aksionare përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike është përgjegjëse për krijimin e letërnjoftimit digjital, administrimin e bazës së të dhënave shtetërore të krijuar për letërnjoftimin digjital, por njëkohësisht edhe krijimin e kushteve për përdorimin e letërnjoftimit digjital nëpërmjet kryerjes së transaksioneve digjitale. Po ashtu, ky nen parashikon edhe të drejtën për krijimin e letërnjoftimit digjital nga shoqëria aksionare përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike, vetë ose nëpërmjet shoqërive të tjera, që përmbushin kushtet, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.

Në nenin 9 të projektligjit parashikohen institucionet e ngarkuara për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe afati për nxjerrjen e tyre.

Në nenin 10 të projektligjit parashikohet hyrja në fuqi e projektligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Brendshme dhe shoqëria aksionare IdentiTek.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore për Çështjet e Brendshme, në Ministrinë e Brendshme, dhe Departamenti Ligjor në IdentiTek.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk sjell efekte në buxhetin e shtetit. Efektet financiare do të përballohen nga buxheti i IdentiTek, sh.a., ose, në varësi të studimit të fizibilitetit, nga shoqëritë e tjera, të cilat kanë kapacitete teknike e financiare, sipas pikës 2, të nenit 6/1, të këtij projektligji.

KËSHILLI I MINISTRAVE